



Agrobizneset, bashkëpunim përtej kufirit - KASH marrëveshje me Këshillin Kombëtar të Luginës së Preshevës

Faqe 5

Zana Konini: FED Invest, e shtrirë në Shqipëri përmes inovacionit dhe rrjetëzimit

Faqe 2

Rreth 72 mijë aplikime në skemën e bujqësisë, interes të shtuar për naftën pa taksa

Faqe 6



AGROBIZNESI

FED invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit qershor 2025 **Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 511** Çmimi 125 lekë E përdryjavshme e pavarur

KATALOGU I PRODUKTEVE BAM PËR TREGJET NDËRKOMBËTARE

UDHËZUES PRAKTIK PËR EKSPORTUES, GRUMBULLUES DHE SHOQATA QË SYNOJNË TREGJET NDËRKOMBËTARE, PËRMES PREZANTIMIT VIZUAL TË STRUKTURUAR DHE TË BESUESHËM TË PRODUKTEVE TË TYRE

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

GQSP ALBANIA
GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



INOVACION

Inteligjenca artificiale në agrobiznes, sfida dhe mundësi për një transformim të qëndrueshëm


Faqe 10

TEMA TË DITËS

- Flija e Kukësit drejt regjistrimit si produkt "Specialitet tradicional i garantuar" Fq.6
- Miratohen 17 projekte nga Komiteti i Monitorimit të Programit Interreg Greqi-Shqipëri Fq.7
- Abuzimi me çmimin e qershive - Prodhim i pakët prej kushteve atmosferike... Fq.11
- Drejtori i Tatimeve, Binaj: Sistem digjital me bankat për mbledhjen e borxheve Fq.10
- Drurët dhe pemët më të pazakonta në Tokë - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

Denaj: Garancia Sovrane dhe Paketa e Maleve nxisin investimet në agroturizëm

Në Reç, Malësi e Madhe, familja Maleci prej rreth 7 vitesh ka krijuar një histori suksesi me investimin në agroturizëm, si një sipërmarrje që ka kthyer traditën, natyrën dhe mikpritjen në një destinacion të preferuar për turistët vendas dhe të huaj.



Faqe 10

AGROTURIZËM

Rabdishti, si model i turizmit rural



Faqe 11

TEKNOLOGJI

Aplikacioni TEA, Rama: Guida digjitale e turizmit tashmë edhe për plazhet



Faqe 6

Mbështetje financiare sektorit rural dhe biznesit të vogël e të mesëm

Zana Konini: FED Invest, e shtrirë në Shqipëri përmes inovacionit dhe rrjetëzimit

Rritja e inovacionit dhe zgjerimi i shërbimeve digjitale ishte kryefjalë e Asamblesë së Përgjithshme të FED Invest zhvilluar në fund të muajit maj në Tiranë. **Kryetarja e Këshillit Drejtues të SHKK FED Invest, Zana Konini, theksoi se, “me vizionin për financa të qëndrueshme, viti 2025 do të fokusohet në përmirësimin e ofertës sonë unike financiare, fuqizimin e kornizës së menaxhimit të riskut, thellimin e personalizimit të shërbimeve për anëtarët në çdo hap të rrugëtimit të tyre financiar dhe zgjerimin e anëtarësisë për të arritur sa më parë gurin kilometrik të 100 mijë anëtarëve”.**

Kjo asamble sipas saj, është manifestim i vlerave tona të përbashkëta, i besimit dhe bashkëpunimit që na ka sjellë deri këtu. Përfshirja financiare për të gjitha segmentet dhe fuqizimi i komuniteteve lokale duket prioriteti i këtij organizmi të mikrofinancës.

Administratori i FED Invest Perlat Sulaj, theksoi forcimin e marrëdhënieve të institucionit me institucione financiare ndërkombëtare dhe me donatorë ndërkombëtarë gjatë vitit të fundit. “Kemi vazhduar të konsolidojmë marrëdhëniet me partnerët e huaj dhe kemi nisur projekte të reja që do të vijojnë të zbatohen edhe gjatë vitit 2025”, theksoi ai. Vitin e kaluar kreditimi nga FED Invest u rrit mbi 8%.

“Institucioni ynë i mikrofinancës synon të jetë porta kryesore për sipërmarrësit e vegjël dhe të mesëm, si në

zonat rurale ashtu edhe në ato urbane, për të marrë shërbime financiare, duke kontribuar në rritjen ekonomike përmes fuqizimit të fermerëve, të rinjve, grave dhe aktorëve të zinxhirit të vlerës”, theksoi Behar Gjoni, Drejtor Biznesi dhe Zëvendës administrator i FED Invest.

Portofoli i kredive u rrit me 8.2%, duke arritur vlerën 6.65 miliardë lekë gjatë 2024, ndër-

riti 5.5 miliardë lekë (rreth 55 milionë euro), me një rritje prej 3% krahasuar me një vit më parë, ndërsa niveli i kredive me probleme zbriti në 6.1%.

Ky është takimi i dymbëdhjetë në historinë 33-vjeçare të institucionit, duke e vendosur atë si kooperativa financiare më e madhe dhe më e konsoliduar në vend, me mbi 97 mijë anëtarë dhe me 58 degë

i dymbëdhjetë në radhë, shënoi një tjetër gur themeli në historinë 33-vjeçare të institucionit tonë si kooperativa financiare më e madhe dhe më e konsoliduar në vend, me mbi 97 mijë anëtarë dhe me 58 degë të shtrira në mbarë vendin.

Kjo Asamble përmbylli takimet e Mbledhjeve të Përgjithshme Vjetore në të gjitha Njësitë Grup/Bazë, ku anëtarë-

digjitale, marketingu efektiv, përfshirja financiare për të gjithë segmentet dhe fuqizimi i komuniteteve lokale.

“Asambleja jonë është më shumë se një mbledhje, është një manifestim i vlerave tona të përbashkëta, i besimit dhe bashkëpunimit që na ka sjellë deri këtu,” theksoi Kryetarja e Këshillit Drejtues, Zj. Zana Konini në fjalën e saj hapëse, duke falënderuar anëtarët, ekipin drejtues dhe partnerët për besimin e mbështetjen e pandërprerë.

Asambleja vlerësoi lart punën e Komitetit të Kontrollit dhe Komiteteve “Anëtarë në Qendër” dhe “Ekipi i Opinionistëve”. Asambleja gjithashtu ritheksoi rolin kyç të Qendrës ABA si katalizator për ekspertizën, informacionin dhe njohuritë agri dhe përfshirje të grupeve vulnerabel në financë dhe ngritje kapacitets, si dhe rikonfirmoi angazhimin për të thelluar bashkëpunimet me partnerët ndërkombëtarë në funksion të rritjes së kapaciteteve, diversifikimit të burimeve të financimit dhe aplikimit të praktikave moderne të bujqësisë së qëndrueshme dhe digjitalizimit, në shërbim të anëtarëve.

Në fund të punimeve, u miratuan vendime të rëndësishme sipas detyrimeve ligjore dhe statutores dhe u miratuan objektivat strategjike për të ardhmen e FED invest.

Vendimet e marra në këtë Asamble përcaktojnë qartë një

drejtim të guximshëm përpara: zhvillim të qëndrueshëm, risi dhe zgjidhje teknologjike dhe angazhim të pandalshëm për mirëqenien financiare të çdo anëtarë të FED invest.

Në Asamble u prezantuan raportet e aktiviteve të KDS, Komitetit të Kontrollit, Raporti i Aktivitetit të SHKK FED invest, Raporti i Audituesit të Jashtëm, Komiteti Anëtarë në Qendër dhe Ekipi i Opinionistëve dhe akte të tjera që lidhen me ecurinë e aktivitetit të SHKK FED invest të cilat janë kompetencat ekskluzive e AZP. Këto vendime janë të rëndësishme dhe do të sjellin vijueshmërinë në të ardhmen.

FED Invest është sot një institucion modern në të gjitha aspektet e qeverisjes dhe praktikave të punës, e specializuar në financimin e bujqësisë, agrobiznesit dhe agroturizmit, me një ofertë unike shërbimesh financiare, por dhe të asistencës së biznesit Agri, nëpërmjet qendrës ABA dhe platformës digjitale ABA online.

Si lider në ofrimin e zgjidhjeve financiare të përbalueshme për popullsinë rurale, FED invest ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin social-ekonomik të Shqipërisë, me mbi 250 mijë kredi dhe gjysmë miliardë euro të injektuara në ekonomi përgjatë 33 viteve të ekzistencës së saj.

Slllogani i FED invest është: Të bashkuar për më shumë mundësi dhe financa sociale.



sa të ardhurat operationale u rritën me 8.8%. Rritja e kredihënies ka ardhur kryesisht nga financimi i aktiviteteve mikro të konsoliduara dhe SME-ve, me një rritje prej 16%. Sektori i bujqësisë ka dominuar rritjen e portofolit të kredisë. Sipas Gjona, janë disbursuar 4,185 kredi të reja me vlerë 3.16 miliardë lekë, kryesisht në sektorët e bujqësisë, blegtorisë dhe shërbimeve. Produkti mikro ka zënë 68% të totalit të kredisë së disbursuar. Në fund të vitit 2024, portofoli i depozitave ar-

të shpërndara në të gjithë Shqipërinë

Më datë 31 Maj 2025, në ambientet e Hotel “Hilton Garden” në Tiranë, në një atmosferë entuziaste dhe me pjesëmarrje të gjerë, Shoqëria e Kursim - Kreditit “FED invest” zhvilloi me sukses Asamblenë e Përgjithshme Vjetore. Asambleja e Përgjithshme është autoriteti më i lartë vendimmarrës dhe demokratik i FED invest, ku anëtarët kanë të drejtën e votës, sipas parimit një anëtar, një votë. Ky takim,

sia u njoh me aktivitetin dhe arritjet e vitit 2024, si dhe objektivat e vitit 2025. Delegatë nga e gjithë Shqipëria, përfaqësues të Njësive Bazë/Grup, u mbledhën në këtë forum për të reflektuar mbi rrugëtimin e vitit 2024, për të vlerësuar arritjet, për të shkëmbyer përvojat dhe diskutuar mbi sfidat dhe zgjidhjet, si dhe për të projektuar së bashku objektivat ambicioze të FED invest-it për vitin 2025. Në qendër të diskutimeve ishin çështje si: rritja e inovacionit dhe zgjerimi i shërbimeve



KATALOGU I PRODUKTEVE BAM PËR TREGJET NDËRKOMBËTARE

UDHËZUES PRAKTIK PËR EKSPORTUES, GRUMBULLUES DHE SHOQATA QË SYNOJNË TREGJET NDËRKOMBËTARE, PËRMES PREZANTIMIT VIZUAL TË STRUKTURUAR DHE TË BESUESHËM TË PRODUKTEVE TË TYRE


Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

Një katalog produktesh i mirë-strukturuar është mjeti bazë i prezantimit profesional. Ai ndihmon eksportuesit, ko-operativat, grumbulluesit dhe shoqatat shqiptare të komu-nikojnë identitetin e markës, cilësinë dhe besueshmërinë tek blerësit e huaj. Katalogu duhet të përgatitet me kujdes – ai shpesh krijon përshtypjen e parë për blerësit e huaj. Ndër faqet hyrëse duhet të pasqyrohet mesazhi i produktit dhe i kompanisë (p.sh. “cilësi”, “inovacion”, etj.). Një katalog pro-fesional e përforcon imazhin e kompanisë dhe ndihmon në zgjerimin ndërkombëtar. Për më tepër, ai u mundëson ek-sportuesve të prezantojnë gamën e plotë të produkteve në një formë të strukturuar, çka rrit shanset për bashkëpunim (klientët mund të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm në një vend).



Figurë 1. Ky artikull është për eksportues, kooperativa, grumbullues dhe shoqata që kërkojnë të promovojnë produktet e tyre në tregjet ndërkombëtare në mënyrë vizuale, të strukturuar dhe të besueshme


Elementët thelbësorë të një katalogu efektiv
Një katalog ndërkombëtar duhet të ketë seksione krye-sore të qarta me përshkrime precize.



Figurë 2. Pse është i rëndësishëm katalogu i produktit?

Më poshtë jepet një tabelë udhëzuese për seksionet tipike dhe përmbajtjen e tyre:

Seksioni i katalogut	Përshkrimi
Mbulesa (e përparme e prapme)	Logoja dhe emri i markës; slogani, foto tjetësuese pasqyruese e produkteve kryesore. Mbulesa tërheq vëmendjen dhe paraqet identitetin
Faqet hyrëse	Prezantim i shkurtër i kompanisë/kooperativës: histori, mision, certifikata etj. Ky seksion krijon kontekstin e parë për blerësin.
Përmbajtja (Table of contents)	Lista e kategorive të produkteve dhe faqeve përkatëse. Lehtëson orientimin në katalog dhe gjetjen e informacionit të nevojshëm.
Kapitujt e produkteve	Secili produkt prezantohet me imazhe cilësore dhe përshkrim. Përshkrimet duhet të përfshijnë emrin e produktit, specifikimet (p.sh. dimensionet, çmimi, materialet, përfitimet, origjinën, certifikatat BIO/organike nëse ka), si dhe mënyrën e porositjes. Sipas standardit francez FAB-DIS, katalogët ndërkombëtarë përfshijnë "informacion të plotë komercial dhe logjistik (emër, përshkrim, vlera etj.), burime multimedia (foto, video, fjalë kyçe), dhe informacion rregullator (etiketa mjedisore, data skadimit, siguria etj.)". Për porosi të mëdha, tregoni çmimet me shumicë, variantet e produktit dhe sasinë minimale të porosisë.
Informacioni për kompaninë/markën	Detajet e kontaktit (adresa, telefoni, email), rrjetet sociale, website. Ky seksion përfshin mundësitë e blerjes dhe pagesës. Mund të përmbajë edhe dëshmi/komente klientësh si prova të besueshmërisë (shiko më poshtë "Dëshmi").



Kjo strukturë (mbulesa, hyrja, përmbajtja, produktet dhe informacioni i kompanisë) garanton që katalogu të jetë gjithëpërfshirës dhe i qartë për përdoruesin. Nëse është e nevojshme, mund të shtohen seksione shtesë si: fjalë për fjalë, guidë përdorimi, ose histori suksesi të klientëve.

Këshilla për përmbajtjen dhe dizajnin Gjuhë e qartë dhe e përshtatur
Përdorni një gjuhë të thjeshtë, pa fjalor të mbushur me terma lokalë. Për tregjet ndërkombëtare, sigurohuni që teksti i katalogut të jetë në anglisht ose në gjuhën e tregut që synoni. Për kompanitë shqiptare, mund të ofrohet edhe versioni dygjuhësh (shqip-anglisht) për të lehtësuar komunikimin. Teksti duhet të jetë konciz dhe informativ – përqendrohuni te karakteristikat kryesore të produktit dhe përfitimet për blerësin. Mospërmbingarkoni faqe me fjalë të panevojshme; përdorni pika listë për të theksuar informacionet kyçe.

Fotografi profesionale
Imazhet janë thelbësore. Sipas udhëzimeve të dizajnit, “katalogët janë mjetë shumë vizuale marketingu dhe duhet të dizajnohen si të tillë. Fotografitë profesionale duhet të përdoren për të prishur monotoni e tekstit dhe për të tërhequr vëmendjen e lexuesit”. Sigurohuni që fotot e produkteve të jenë me rezolucion të lartë (min. 300 DPI për printim), të ndriçohen mirë dhe të paraqesin produktin nga kënde të ndryshme. Nëse nuk keni buxhet për fotograf profesioniste, mendoni t'i realizoni vetë me kujdes (si në natyrë, tek njerëz që përdorin produktin) ose të blini foto cilësore stock për elementë të përgjithshëm. Evitoni imazhet e paqarta ose të zbehta – ato ulin vlerën e perceptuar të produktit.

Simbolet standarde
Përfshini simbole të njohura ndërkombëtarisht që informojnë për cilësi ose funksionim: p.sh. etiketat organike, reciklimi, alergjenët, temperaturat e ruajtjes, fryraret/fragile, etj. Këto simbole (p.sh. simboli i CE, simbolet ISO, logoja e përqindjes organike) ndihmojnë blerësit të kuptojnë lehtësisht specifikimet mjedisore dhe teknike. Në parashkrimin e paketimit përdorni simbole të standardizuara të paketimit për import/eksport (p.sh. një kuti me shigjeta për “kjoana lart”, shigjeta me diell për “mos ekspozoni në diell” etj.). Këto detaje i bën katalogun më profesional dhe informues.

Dëshmitë (testimonials)
Përfshini në katalog komente ose vlerësime të klientëve ekzistues (dëshmi). Sipas praktikave të marketingut, klientët kanë më shumë besim tek prodhimet që rekomandohen nga njerëz të tjerë. Mund të rezervoni një seksion të veçantë për “Mendimet e klientëve”, ose të vendosni citate pranë prezantimit të produkteve. Testimonialet të shkurtra dhe të sinqerta (emri i klientit/kompanisë dhe komenti i tyre) forcojnë besueshmërinë e markës. Një studim sugjeron që blerësit janë më të prirur të blejnë një produkt që është vlerësuar lart nga bashkëmoshatarët. Kjo veçori është veçanërisht e vlefshme për produktet me cikël blerjeje të gjatë ose me nevojë për besim të lartë nga klientët e huaj.

Konsistenca grafike
Përdorni vetëm 2-3 fonte dhe ngjyra kryesore që reflektojnë identitetin tuaj. Kapitujt dhe faqet duhet të kenë stil të njëjtë (pikënisje e ngjyrave, vendosje e logos, gjerësi margjina). Sipërfaqja e bardhë (white space) është e rëndësishme – ai ndihmon në qartësim dhe bën që faqja të duket e pastër. Shmangni dizajne mbipopulluese: çdo faqe nuk duhet të ketë më shumë se 2–4 produkte kryesore, me përshkrim të shkurtër dhe pika me informacion. Kështu, lexuesi nuk do ndjehet i mbingarkuar dhe produktet spikatin më shumë.

FINANCIM

BE, 1,2 milionë euro grante për shoqërinë civile dhe grupet në nevojë në Shqipëri

Bashkimi Evropian (BE) dhe UNDP në Shqipëri prezantuan 12 projekte të zbatuara nga 12 organizata të shoqërisë civile (OSHC) për të përmirësuar shërbimet e punësimit dhe zhvillimin e aftësive për grupet në nevojë në 19 bashki në Shqipëri.

Të financuara në kuadër të projektit BE për Përfshirjen në Tregun e Punës (EU4-LMI), këto grante synojnë të rrisin punësimin dhe zhvillimin e aftësive për grupet që nuk janë në punësim, arsim ose trajnim (NEET), nënat e reja, komunitetet rome dhe egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara dhe përfutuesit e ndihmës ekonomike.

Ceremonia, e mbajtur në Shkollën Teknike Profesionale në Korçë, tregon një angazhim të përbashkët për zhvillim ekonomik gjithëpërfshirës dhe akses të barabartë në punë të denjë për të gjithë

shqiptarët.

Në ceremoni morën pjesë ambasadori i Bashkimit Evro-

jmë politikën në praktikë, duke ofruar mundësi reale për njerëzit në rrezik për-

Qeverinë për të çuar përpara reformat në sektorin social dhe për t'u përafëruar me kërkesat e anëtarësimit në BE, veçanërisht me Kapitullin 19

shirëse, ku askush nuk lihet pas", tha ambasadori i BE-së Silvio Gonzato.

"UNDP-ja është krenare për partneritetin me Bash-

të mirë në tregun e punës".

Skema e granteve prej 1.2 milionë euro, që koordinohet në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) në Shqipëri, do të ofrojë shërbime sipas nevojave gjatë 16 muajve të ardhshëm duke u fokusuar në tre drejtime: Këshillim Intensiv për Punësim; Trajnim për Aftësi Bazë; Punësim me Mbështetje dhe Zhvillimi i Aftësive për Personat me Aftësi të Kufizuara.

EU4LMI, i financuar nga BE-ja dhe i zbatuar nga UNDP-ja në Shqipëri në partneritet me Shërbimin Publik të Punësimit Suedez dhe Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, promovon rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse përmes bashkëpunimit me AKPA-n, ministrinë e linjës, shërbimet sociale shtetërore, bashkitë dhe OSHC-të.



pian në Shqipëri, Silvio Gonzato, përfaqësuesja e Përher-shme e UNDP-së në Shqipëri, Randi Davis dhe kryetari i bashkisë së Korçës, Sotirag Filo.

"Me këto grante të financuara nga BE-ja, ne po e kthe-

jashtimi për të fituar aftësi, për të gjetur punë, si dhe për të ndërtuar jetë më të mira. Kjo nismë është pjesë e një programi më të gjerë ndihme të BE-së, prej 70 milionë eurosh, për përfshirjen sociale në Shqipëri, duke mbështetur



mbi politikën sociale dhe punësimin. Sepse integrimi në BE nuk ka të bëjë vetëm me përafrimin e ligjeve, por edhe me ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më gjithëpërf-

kimin Evropian në këtë ndërhyrje strategjike", tha Randi Davis, përfaqësuese e përher-shme e UNDP-së në Shqipëri. Këto projekte do t'i fuqizojnë grupet vulnerabel me akses më

Udhëzues praktik për eksportues, grumbullues dhe shoqata që synojnë tregjet ndërkombëtare, përmes prezantimit vizual të strukturuar dhe të besueshëm të produkteve të tyre

(Vijon nga faqja 3)

Formatet vizuale

Përveç fotove të produkteve, përdorni ikona të vogla për pikat kryesore (p.sh. shqiptonjë për "Made in Albania", simbol O për organik, etj.). Grafikë e thjeshta (si tabela e madhësive, skema përdorimi, ose grafike shpjeguese) e bëjnë katalogun më gjithëpërfshirës. Sigurohuni që logoja dhe elementët e markës të jenë të dukshëm në mbulim dhe këndfletë.

Çfarë të përfshihet tek teksti

Përshkrimet e produkteve duhet të jenë të qarta, përmblendhëse dhe informative. Përmendni veçoritë kryesore dhe përparësitë konkurruese të produktit (p.sh. "me strukturë organike", "me aromë tradicionale", "i pershtatshëm për tregjet BIO" etj.). Vendosni theks tek benefitet për përdoruesin: pse ky produkt është i rëndësishëm për blerësin? Përftojini lexuesit me çmim të kualitetit/çmimi në raport me produktet e tjera.

Çmimi dhe termat e shitjes

Çmimi për njësi (p.sh. €/kg ose €/pako), bashkë me sasinë minimale të porosisë. Në katalogët për tregje të mëdha, tregoni çmimet me shumicë (p.sh. €/pako për 10+ kuti) dhe varietetet (ngjyra, dimensione).

ishin të mbledhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të certifikuar me FairWild. Katalogu u shpërnda në një panair në Amsterdam dhe rezultoi në dy kontrata pilot për rigon dhe trumzë.



Mënyra e porositjes

Informacion lidhur me transportin, pagesën, kushtet e dorëzimit. Kjo mund të jetë e shkruar në fund të përshkrimit ose në një seksion informues të përbashkët.

Elemente vizuale shtesë

Ikonat e standardeve (p.sh. logot CE, USDA Organic, ISO etj.), vlerësime yjesh ("4.5/5 nga klientët"), ose certifikata të veçanta (foto të medaljeve). Në një katalog interaktiv, vendosni edhe QR code që lidh blerësin me webfaqen e produktit. (Shih figurën 3)

Për shembull, sipas një modeli katalogu për tregtinë me shumicë, secili produkt tregon "specifikimet, çmimet me shumicë dhe sasinë minimale pa e ngarkuar lexuesin". Në katalogë të avancuar (p.sh. për tregje Europiane), duhet të përfshini edhe fjalë kyçe dhe përshkrime më të gjera për shfletuesit online, por në versionin print shtyni informacionin në formë tabelore të thjeshtë.

Burime dhe modele për ndihmë

- Mund të përdorni **template falas** në **Canva**, **PowerPoint** ose **Adobe Express**
- UNIDO, GQSP mund të ofrojnë shembuj të katalogëve të suksesshëm
- Konsultohuni me një **agent marketingu B2B** ose **grafik dizajner lokal** për personalizim

Shembull suksesi

Një kooperativë në Gjirokastrë krijoi një katalog 4-faqesh në anglisht, ku theksoi se gjithë produktet

Formati	Rekomandime
PDF (3-6 faqe)	Për email dhe shpërndarje në panair
Fizik (broshurë A4)	Printim në ngjyra për ekspozita ose takime
Online (link i shkurtuar)	Mund ta hostoni në Google Drive ose faqe të thjeshta të kompanisë
QR Code	Për t'u vendosur në kartvizita, etiketa ose ekspozitorë

Për çdo produkt në katalog, mund të përdorni struktura uniforme. Për shembull:

Foto e produktit

Një imazh i plotë ose disa pamje nga kënde të ndryshme, që tregojnë mirë veçoritë e jashtme. Fotografoni produktin në përdorim dhe në ambient minimalist.


Emër dhe kategorinë: P.sh. "Ullinj të Zeza Tradicionale – Kategoria Extra".

Përshkrim i shkurtër

Një frazë me pikat kryesore ("Ullinj të tanë janë të korrur me dorë dhe paketa 1 kg mbushet menjëherë pas vjeljes"). Nxirrni në pah certifikata (p.sh. "Certifikuar BIO" ose "Vlerësuar me medalje ari në panairin ushqimor të 2024-s").

Specifikat teknike

Tabela ose listë me dimensione (peshë, temperatura ruajtje, përbërësit/ingredientët, etj.). Për modele teknike mund të përdorni një tabelë të vogël ose ikonë ilustrative.



Figurë 3. Shembull strukturimi i një produkti në katalog

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Agrobizneset, bashkëpunim përtej kufirit - KASH marrëveshje me Këshillin Kombëtar të Luginës së Preshevës

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) dhe Këshilli Kombëtar Shqiptar (KKSH), i Luginës Preshevë, komonat Preshevë, Medvegjë, Bujanovc, kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit, në sektorët dhe subjektet prodhuese të zinxhirit të furnizimit me ushqime si ato të Bujqësisë, Blegtorisë, Agrobiznesit dhe Tregjeve Agro-Blegtorale, Agropërpunimit dhe Subjekteve të Ushqimit Social, Turizmit Rural dhe Mjedisit, Bimëve Aromatiko-Mjekësore dhe Agropylltarisë, Bujqësisë Organike dhe Bletarisë, Financës dhe Mikrofinancës, si dhe Zejtarisë.

Ndër të tjera bashkëpunimi ka si qëllim përmirësimin e legjislacionit që impakton zonat rurale dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së. Rritjen e masës së disbursimit të financimit në zonat rurale, për disbursimin e fondeve, granteve të vëna në dispozicion për këto sektorë nga qeveria dhe donatorët nëpërmjet përgatitjes së projekteve të përbashkëta, përmes Programit financiar IPA, Cross- Border, Programit HORIZON 2020, gjithashtu dhe programeve të tjera të ndihmës nga institucione publike dhe private.

Ky Memorandum siguron kuadrin rregullator brenda të cilit:

- Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH)**, Organizatë om-brellë jo fitimprurëse, themeluar me vendim nr. 3050 dt.20.10.2000 të Gjykatës Rrethit Gjyqsor Tiranë, me seli ne Rugen “Mine Peza”, Pallati 87/3 Hyrja 2, Kati 1, Tirane, me NIPT nr. K41714011H, përfaqësuar nga kryetari **Z. Agim Rrapaj**, mbajtës i ID nr. F50718094U.

Dhe

Këshilli Kombëtar Shqiptar, me seli në Rruga “K.Petrovic” numër 237, Bujanovc, 17520, përfaqësuar nga kryetari **Z. Enkel Rexhepi**

Palët angazhohen:

Të zhvillojnë marrëdhënie bashkëpunimi, që të kontribuojnë reciprokisht në frenimin e shpopullimit, zhvillimin social e ekonomik të Luginës së Preshevës, në veçanti zhvillimin e zonave rurale, në sektorët kryesorë, objekt të këtij memoran-dumi si atë të: **1. Bujqësisë, 2. Blegtorisë, 3. Agrobiznesit & Tregjet Agro-Blegtorale, 5. Agropërpunimit & Subjek-teve të Ushqimit Social, 6. Turizmit Rural dhe Mjedisit, 7. Bimëve Aromatiko Mjekso-re & Agropylltarisë, 8. Bujqësisë Organike dhe Bletarisë, 9. Financës & Mikrofinancës, 10. Zejtarisë.**

Kreu II
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
Neni 1
Objekti i memorandumit

1.1 Vendorsja e bashkëpunimit institucional në mes të “Këshil-lit të Agrobiznesit Shqiptar” në vijim (KASH), Tiranë, Shqipëri dhe Këshillit Kombëtar Shqiptar në vijim (KKSH) për të shkëm-byer eksperiencën dhe organizuar aktivitete të përbashkëta dhe zbatuar projekte, për zhvillimin e qendrueshëm të ekonomisë, konservimin e produkteve tradicionale bujqësore, dhe permires-imin e mjedisit të agrobiznesit dhe biznesit veçanërisht në Lugi-nën e Preshevës, komonat: Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc, në vijim (Lugina).

Neni 2

2.1 Objekti kryesor i bashkëpunimit do të jenë sektorët dhe subjektet prodhuese të zinxhirit të furnizimit me ushqime si ato të: 1. Bujqësisë, 2. Blegtorisë, 3. Agrobiznesit & Tregjet Agro-Blegtorale, 4. Agropërpunimit & Subjekteve të Ushqimit Social, 5. Turizmit Rural dhe Mjedisit, 6. Bimëve Aromatiko-Mjekësore & Agropylltarisë, 7. Bujqësisë Organike dhe Bletarisë”, 8. Fi-nancës & Mikrofinancës, 9. Zejtarisë. Përmirësimi i legjislacionit që impakton zonat rurale dhe përafrimi me legjislacionin e BE. Rritja e masës së disbursimit të financimit në zonat rurale, për disbursimin e fondeve, granteve të vëna në dispozicion për sek-torët e sipërcituara nga qeveria dhe donatorët nëpërmjet për-gatitjes së projekteve të përbashkëta, përmes Programit finan-ciar IPA, Cross- Border, Programit HORIZON 2020, gjithashtu dhe programeve të tjera të ndihmës nga institucione publike dhe private.

Kreu III
FUSHAT E BASHKËPUNIMIT
Neni 3

3.1 Bashkëpunim në konsolidimin e procesit të kooperimit dhe koordinimit në fushën e Ekonomisë Ushqimit, me synim ndërtimin e një modeli eficient, për të përdorur potencialet e pashfrytëzuara dhe për të rritur efektivitetin e veprimtarisë social-ekonomike me fokus Luginën,

3.2 Bashkëpunim në hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta për frenimin e shpopullimit, promovimin e produk-teve me fokus produktet tradicionale dhe mënyrën e përgatitjes së tyre tradicionale nga shqiptarët e Luginës, duke u bazuar në përmirësimin e veprimtarisë në fushën e kooperimit dhe koordin-imit, edukimit dhe trajnimit, mekanizimit, inovacionit dhe dixhitaliz-imit, rritjen e masës së financimit, me synim rritjen e cilësisë dhe efijcencës në sektorët e Ekonomisë së Ushqimit në tërësi, si dhe në uljen e kostove të produkteve në veçanti.

3.3 Bashkëpunim në fushën juridike, për të përmirësuar legjis-lacionin aktual duke e përafruar hap pas hapi me atë të BE-së.

3.4 Në nivel institucioni palët angazhohen, që të mundësojnë shkëmbim të njohurive, arsimim të stafeve dhe përdorimin e in-frastrukturës për bashkëpunim në zbatimin e projekteve me in-teres reciprok.

Kreu IV
FORMA DHE MËNYRA E BASHKËPUNIMIT
Neni 4

Për të realizuar objektivin dhe qëllimin e këtij memorandumi palët bien dakord në parim që:

4.1 Të krijohet e miratohet një sekretariat dhe komitet teknik i përbashkët koordinimi, i përbërë nga ekspertë me përvojë, i cili do të organizojë punën dhe përgatisë sipas standardeve të kërkuara të gjithë draft-dokumentet me argumentet e duhura, me synim për t’u miratuar si një paketë e veçantë në organet vendimmarrëse të subjekteve nënshkruese, si dhe ndjekjen e procedurave të mira-timit në organet vendimmarrëse.

4.2 Të përzgjidhen e miratohen studio të specializuara për mbështetjen e sekretariatit dhe komitetit Teknik, si dhe të llogar-ritet, mundësohet e miratohet sipas rregullave të çdo subjekti nën-shkrues një buxhet i domosdoshëm, për realizimin e veprimtarisë së sekretariatit dhe komitetit teknik të koordinimit.

4.3 Të shkruhet, miratohet e zbatohet një program pune koordinues i komitetit teknik, me afate kohore të përcaktuara. Të llogaritet kontributi paraprak teknik dhe financiar, që duhet dhe mund të japë secili subjekt pjesëmarrës dhe partnerët e tyre në realizimin e qëllimit dhe objektit të këtij memorandumi.

Neni 5
KOMUNIKIMI I NDËRSJELLË

5.1 Palët do të shkëmbejnë rregullisht informacion në lidhje me të gjitha çështjet e parashtruara në këtë Memorandum.

5.2 Komunikimi i ndërsjellë dhe çdo informacion tjetër në funk-sion të zbatimit të kërkesave të këtij Memorandumi do të realizo-

het përmes pikave të kontaktit të Palëve, duke përdorur postën elektronike zyrtare.

5.3 Kur Palët bien dakort, përdoren edhe mënyra të tjera për shkëmbimin e informacionit dhe të komunikimit të ndërsjellë.

5.4 Gjatë komunikimit shkresor ose elektronik për zbatimin e këtij Memorandumi, pikat e kontaktit të Palëve, angazhohen t’i japin përgjigje njëra tjetrës sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë kalendarike.

Neni 6
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

6.1 Palët do të sillen me korrektësi gjatë përmbushjes së de-tyrimeve reciproke dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre, pa cënu-ar interesat e njëra-tjetrës.

6.2 Gjatë realizimit të kërkesave të Memorandumit, Palët do të zbatojnë në mënyrë reciproke kërkesat e legjislacionit në fuqi, lidhur me veprimtarinë e tyre institucionale.

6.3 Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi, zgjidhet me negociata e mirëkuptim mes Palëve.

Neni 7
KONFIDENCIALITETI

7.1 Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhë-nave dhe informacioneve të përfituara gjatë zbatimit të Memoran-dumit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi të secilit vend.

7.2 Ky detyrim është i vlefshëm pa afat kohor.

Neni 8
SHTESAT DHE NDRYSHIMET

8.1 Ky Memorandum mund të ndryshojë përmes negocimit paraprak të çështjeve dhe vetëm me marrëveshje ndërmjet Palëve

8.2 Çdo ndryshim reflektohet me shkrim dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve

Kreu V
HYRJA NË FUQI DHE KOHËZGJATJA
Neni 9

9.1 Ky Memorandum Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga të dy Palët.

9.2 Kohëzgjatja e këtij Memorandumi është deri kur njëra nga Palët kërkon zyrtarisht ndërprerjen e bashkëpunimit.

9.3 Ky Memorandum Bashkëpunimi, nuk është detyrues për Palët, mund të ndryshohet në çdo kohë nga palët në bazë të vull-netit të lirë të tyre, të shprehur e argumentuar paraprakisht me shkrim.

9.4 Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen në Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar (KASH) Shqipëri, 2 dy kopje Këshllit Kom-bëtar Shqiptar KKSH.



INFORMACIONE

Rreth 72 mijë aplikime në skemën e bujqësisë, interes të shtuar për naftën pa taksa

Rreth 71 mijë fermerë aplikuan për të përfutur subvencion në bujqësi, nga të cilët 90% e tyre kërkojnë të përfutojnë naftën pa akcizë. Ndërkohe që me 30 maj në mesnatë u mbyll afati për aplikimin në Skemën Kombëtare të Subvencioneve në Bujqësi 2025.

Sipas Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, interesi i fermerëve për të përfutur nga Skema Kombëtare është tejet i lartë dhe kjo falë mbështetjes financiare për këtë sektor, që ka qenë çdo vit në dispozicion të tyre.

Skema e mbështetjes për naftë pa taksa, vijon për të pestin vit radhazi. Edhe këtë vit nafta do të shpërndahet nëpërmjet pagesës në lekë për hektar, në llogarinë bankare të çdo fermeri aplikues, e përllogaritur në bazë të normativave të konsumit të naftës, për sipërfaqe më të mëdha se 1 hektar.

Fermerët me sipërfaqe më të mëdha se 10 hektarë, do të përfutojnë 50% të masës së financimit për çdo hektar të mbjellë me kultura bujqësore.

Aplikuesit në grupimet e Bashkimit të Fermerëve, do të përfutojnë të parët dhe secili prej tyre do të marrë në llogari të veçantë masën e financimit në nivelin maksimal.

Qeveria ka vënë në dispozicion të fermerëve subvencione për 8 masa që do të financohen, ku përfshihet mbështetja për tufën bazë të matrikular/lopë/ dele dhe dhi; mbarësh-

timi i bletarisë; mbështetje për fara/fidanë dhe impute të tjera; mbështetje për kultivimin e bimëve aromatiko-mjekësore; mbështetje për fermat organike; certifikimi Global GAP; si dhe



mbështetje me naftë për punime të mekanizuara në bujqësi.

Aplikimet e Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi u hapen më 14 Prill. Ata që kanë lopë do të marrin 10 mijë lekë për krerë, ndërsa ata që mbarështojnë të imëta 1 mijë e 200 lekë. Me 1 mijë lekë do të mbështeten bletarët, ndërsa kultivuesit e perimeve, luleshtrydheve dhe rrushit do të marrin 200 mijë lekë për hektarë. Per bimët medicinale, mbështetja është 30 mijë lekë/ hektarë.

Sa i takon shpërndarjes gjeografike, edhe këtë vit numri më i lartë i aplikimeve është në qarqet ku bujqësia e blegtoaria është më e zhvilluar, si Fier, Korçë, Berat dhe Elbasan.

Fondet e vëna në dispozi-

cion për fermerët, kanë rritur ndjeshëm formalizmin në bujqësi, pasi kushti kryesor për të përfutur është pasjisa me NIPT. Këtë vit janë mbi 5,200 fermerë të cilët janë pajisur

rishtazi me NIPT në tatime.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural financoi 67 133 fermerë në shkallë vendi, përmes Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi 2024. Nga të cilët 52 195 fermerë përfutuan mbështetje për naftë, 3 503 fermerë u financuan për tufën bazë të matrikulluar gjedhë, 5 089 për tufën bazë të matrikulluar të imta, 4 056 për bletarinë, 105 për fermat organike, 3 fermerë për certifikimin Global Gap, 1406 fermerë për fara, fidanë dhe impute të tjera dhe 75 fermerë u financuan për bimët mjekësore – aromatike.

Pagesat u realizuan në masën 100%, me një fond total prej 5,2 miliardë lekësh.

AKU: Vezët pa salmonelë, kontaminimi ndodhi në ambientet e kopshtit të Gramshit

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) sqaroi opinionin publik lidhur me situatën në



kopshtin Nr. 1 në Gramsh, pas verifikimeve zyrtare të gjurmueshmërisë për produktin vezë.

Sipas AKU-së, mostrat e marra nga prodhuesi i vezëve dhe subjekti furnizues, që furnizonte edhe kopshtin, kanë rezultuar negative për salmonelë

spp. Gjithashtu, testimet në fermën e shpendëve gjatë muajit maj 2025 treguan se shpendët janë të shëndetshëm dhe pa praninë e salmonelozës.

Nga ana tjetër, mostrat e marra në ambientet e kopshtit Nr. 1 Gramsh kanë rezultuar pozitive për salmonelë spp, duke treguar se kontaminimi ka ndodhur në ambientet e kopshtit dhe jo përmes vezëve të furnizuara.

AKU thekson se postimet në disa rrjete sociale, të ndryshme nga ky njoftim zyrtar, janë të pasakta dhe përbëjnë dezinformim publik.

“Sipas ligjit “Për ushqimin” dhe VKM 760/2015, procesi i

gjurmueshmërisë është i detajuar dhe përfshin gjithë hallkat e zinxhirit ushqimor, duke nisur nga subjekti i ngjarjes, furnizuesi e deri tek prodhuesi. Komente të papërgjegjshme dhe të parakohshme mbi rezultatet e analizave janë të papranueshme dhe mund të sjellin masa ligjore”, informoi AKU.

AKU paralajmëron se kushdo që bën deklarata të pasakta mund të jetë objekt i procedimeve penale.

Institucioni garanton angazhimin e vazhdueshëm dhe bashkëpunimin me institucionet për mbikëqyrjen e situatës dhe për informim të saktë publik

Lehtësohet raportimi financiar i subjekteve, QKB marrëveshje me IEF

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) dhe Instituti i Ekspertëve Fiskalë (IEF) nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit për lehtësimin dhe përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar të subjekteve në Shqipëri.

Sipas QKB-së, marrëveshja mundëson ofrimin pa pagesë të platformës digjitale SmartFin, një zgjidhje moderne për bizneset shqiptare për fiskalizim elektronik, kontabilitet dhe auditim në kohë reale

Gjithashtu krijon mundësi për programe trajnimi falas nga IEF për personelin e QKB-së në fushat e raportimit financiar



dhe jo vetëm.

Në një njoftim të saj, QKB thekson se, ky bashkëpunim shënon një hap të rëndësishëm

në drejtim të modernizimit të shërbimeve publike dhe aksesit të biznesit në teknologjitë inovative financiare.

Flija e Kukësit drejt regjistrimit si produkt “Specialitet tradicional i garantuar”

Flija e Kukësit është një tjetër produkt autokton shqiptar, që po shkon drejt procesit të regjistrimit si markë e mbrojtur pasi ka kaluar testet e verifikimit të përputhshmërisë për treguesit gjeografikë, emërtimin e origjinës dhe traditës, për të marrë kështu logon kombëtare dhe prezantimin e tij në treg si “Specialitet Tradicional i Garantuar”.

Ekspertë të bujqësisë dhe donatorë të fushës, organizuan një aktivitet të veçantë mbi fli-në, tek një bujtinë në Kukës, për të promovuar turizmin rural dhe trashëgiminë lokale.

Pesë gra vendase gatuan FLI-në tradicionale, e cila u shijua në një degustim si hap i parë drejt regjistrimit të saj si Specialitet Tradicional i Garantuar (TSG).

Në aktivitet ishin të pranishëm edhe anëtarë të Komisionit të Skemave të Cilësisë, për të përzgjedhur versionin më autentik.

Promovimi dhe certifikimi i produkteve autentike shqiptare është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të turizmit rural

në Shqipëri.

Aktualisht Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka certifikuar deri tani me emërtim “Specialitet Tradicional i Garantuar” 4 produkte tipike: Djathi i Ziem, Veleçik,

Shkodër; Mjalti i Bedunicës, Përmet; Djathi i Dhisë, Bjeshkët e Runjës, si dhe djathin e Mishavinës të Kelmendit, që i japin vlerë të shtuar traditës së trojeve tona nga veriu në jug të Shqipërisë.



Aplikacioni TEA, Rama: Guida digjitale e turizmit tashmë edhe për plazhet

Aplikacioni TEA këtë sezon veror ofron një përvojë të përmirësuar dhe më gjithëpërfshirëse për të gjithë ata që dëshirojnë të eksplorojnë bukuritë natyrore dhe kulturore të vendit.

Kryeministri Edi Rama në një postim në rrjetet sociale tha se “Aplikacioni TEA sjell një valë të re inovacioni për sezonin veror”.

“Të gjithë plazhet publike dhe private të Shqipërisë i gjeni me një klikim në telefonin tuaj, si asnjëherë më parë. Me aplikacionin TEA, zbuloni plazhet, shërbimet dhe eventet më të bukura për një verë pa kufij”, theksoi Rama.

Kryeministri Rama i bëri thirrje qytetarëve dhe turistëve të shkarkojnë aplikacionin TEA.

“Shkarkoni falas TEA, guidën turistike 360° në App Store dhe Google Play, dhe çdo ditë e verës suaj do të jetë një aventurë e re”, tha Rama.

Versioni më i fundit i TEA-s, Guidës Digjitale 360° për turizmin në Shqipëri, përmban: informacion të detajuar mbi plazhet publike dhe private përgjatë të gjithë vijës bregde-

tare shqiptare; Imazhe, pershkrime dhe koordinata të sakta për secilin destinacion bregdetar; Mundësi raportimi të shkeljeve apo problematikave, duke e kthyer aplikacionin në një mjet bashkëpunues mes turistëve dhe institucioneve; Evente kulturore, sportive dhe tradite, për të promovuar dimensionin shumëplanësh të turizmit në Shqipëri; Shërbime utilitare, që ndihmojnë turistët në planifikimin dhe orientimin gjatë udhëtimit të tyre në Shqipëri.

TEA nuk është thjesht një aplikacion informativ. Ai për-

faqëson një filozofi të re të zhvillimit të turizmit, të bazuar në teknologji, transparencë dhe përfshirje qytetare. Përdoruesit tashmë kanë një burim të besueshëm në telefonin e tyre, që jo vetëm i orienton drejt përvojave më të mira, por edhe i fuqizon për të ndikuar pozitivisht në përmirësimin e shërbimeve.

Duke ndërtuar ura midis trashëgimisë natyrore, kulturës dhe teknologjisë, Shqipëria po pozicionohet gjithnjë e më shumë si një destinacion inteligjent dhe mikpritës në hartën e turizmit ndërkombëtar.



FINANCIM

Solovova: Mbështetje financiare dhe teknike për integrimin në BE të Shqipërisë

Drejtoresha e Zyrës së BERZH-it në Shqipëri, Ekaterina Solovova, deklaroi se Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim do të vijojë të mbështesë Shqipërinë në rrugëtimin e saj drejt Bashkimit Evropian jo vetëm përmes financimeve, por edhe përmes asistencës teknike.

Deklarata u bë gjatë konferencës së zhvilluar në ambientet e Bankës së Shqipërisë, me rastin e prezantimit të Raportit të Tranzicionit të BERZH-it për vitin 2024–2025, “Navigating industrial policy”.

Në këtë aktivitet mori pjesë edhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko.

Solovova bëri të ditur se bordi i BERZH-it ka miratuar strategjinë e re 5-vjeçare për Shqipërinë, e cila ndërtohet mbi angazhimin shumëvjeçar të institucionit në vend.

“Bordi ynë miratoi strategjinë e re 5-vjeçare për Shqipërinë, e cila bazohet në angazhimin tonë në Shqipëri gjatë periudhës strategjike me afërsisht 900 milionë euro financime dhe asistencë teknike, dhe synon të mbështesë progresin e shpejtë të Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE”, tha drejtuesja e BERZH-it në Shqipëri.

Sipas saj, strategjia është plotësisht e harmonizuar me objektivat globale të BERZH-it dhe është përshtatur me prioritetet dhe nevojat specifike të Shqipërisë.

Ndër prioritetet kryesore të strategjisë, Solovova tha se është përshejtimi i tranzicionit drejt ekonomisë së gjelbër.

“BERZH do të vijojë të mbështesë Shqipërinë në di-

versifikimin dhe zgjerimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, përmes asistencës në hartimin e politikave, financimit të kapaciteteve të reja dhe përmirësimit të rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes”, theksoi ajo.



Një tjetër fushë me rëndësi, sipas saj, është përmirësimi i efikasitetit energjetik në shërbimet publike dhe bashkiake, si dhe mbështetja për institucionet financiare partnere dhe klientët e sektorit privat në forcimin e kapaciteteve të tyre.

“Strategjia gjithashtu synon të ndihmojë sektorin privat shqiptar që të përgatitet për akses në tregun e përbashkët evropian. Kjo do të arrihet përmes rritjes së financimit direkt dhe indirekt, përmirësimit të konkurrueshmërisë dhe integritetit të bizneseve shqiptare në zinxhirët globalë të vlerës. Financimi do të shoqërohet me asistencë teknike të shënjestruar për rritjen e produktivitetit dhe nxitjen e inovacionit”, deklaroi Solovova.

Një tjetër element i rëndë-

sishëm i strategjisë, vuri në dukje ajo, është përmirësimi i klimës së investimeve të huaja dhe modernizimi i infrastrukturës.

“BERZH do të vijojë të mbështesë ndërmarrjet shtetërore në përmirësimin e qeverisjes së tyre korporative

dhe praktikave në fushën e mjedisit, shoqërisë dhe qeverisjes (ESG). Po ashtu, institucioni do të investojë në zhvillimin e infrastrukturës kyçe të lidhjes, duke ofruar edhe asistencë teknike”, siguroi Solovova.

Në përfundim, Solovova theksoi se e gjithë kjo mbështetje do të vijojë në bashkëpunim të ngushtë me Bashkimin Evropian, institucionet e tjera financiare dhe donatorët ndërkombëtarë, për të maksimizuar ndikimin në dobi të Shqipërisë dhe qytetarëve të saj.

“Do të vijojmë të sigurojmë koordinim të ngushtë me institucione të tjera financiare, BE, partnerët të tjerë ndërkombëtarë dhe donatorë për të maksimizuar ndikimin në dobi të Shqipërisë dhe popullit shqiptar”, deklaroi Solovova.

68 organizata të shoqërisë civile nga Ballkani Perëndimor: BE, fonde të dedikuara për tranzicion të drejtë të rajoneve

68 organizata të shoqërisë civile nga rajoni i Ballkanit Perëndimor publikuan një deklaratë të përbashkët, duke i bërë thirrje Bashkimit Evropian të sigurojë fonde të dedikuara për mbrojtjen e mjedisit dhe për një tranzicion të drejtë të rajoneve me ekonomi të bazuar

bje dhe Qëndrueshmëri të BE-së (Recovery and Resilience Facility) dhe me Instrumentin për Reformë dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor (Western Balkans Reform and Growth Facility). Ky sistem parashikon shpërndarjen e fondeve drejt buxheteve të vendeve mbi ba-

ajo të mbulojë pothuajse të gjithë fondet e BE-së”, u shpreh ai.

Ndërsa, Ognjan Pantić nga Shkolla e Hapur e Beogradit vuri në dukje se përshtatja me legjislacionin mjedisor të BE-së është pjesa më sfiduese e procesit të anëtarësimit dhe tranzicioni i drejtë i rajoneve me bazë qymyri tashmë është me vonesë.

“Prandaj, BE-ja duhet t’i mbështesë këto procese, bashkë me shoqërinë civile, pavarësisht nga performanca e përgjithshme e qeverive të Ballkanit Perëndimor. Financimi duhet të jetë i qëndrueshëm, i parashikueshëm dhe i lidhur me projekte konkrete. Ai nuk mund të varet nga reformat qeveritare që mund të mos ndodhin kurrë”, theksoi ai.

Grupet theksojnë gjithashtu nevojën për përmirësime domethënëse në qasjen e Mekanizmit për Reformë dhe Rritje të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë konsultime publike kuptimplota, në kohën e duhur dhe efektive mbi reformat dhe investimet e planifikuara, përfshirjen e më shumë reformave mjedisore, duke përfshirë ndëshkime të forta për shkeljet ligjore, si dhe një fokus më të madh tek qeverisja përmes ligjit dhe përmirësimet mjedisore dhe sociale, përpara rritjes ekonomike si qëllim në vetvete.

Komisioni Evropian pritet të paraqesë kuadrin e ardhshëm financiar në mes të korrikut 2025, duke i dhënë fund muajve të spekulimeve mbi përmatat dhe strukturën e tij.



në lëndë djegëse si qymyri, në Ballkanin Perëndimor, në buxhetin e BE-së pas vitit 2027.

Sipas organizatave, deri më tani, nuk ka pasur financime të posaçme për komunitetet që varen nga qymyri në rajon. Financimet për mbrojtjen e mjedisit dhe shoqërinë civile janë ofruar kryesisht përmes Instrumentit për Asistencë të Para-Aderimit (IPA). Megjithatë, tani duket se mbështetja e BE-së për Ballkanin Perëndimor në buxhetin 2028–2034 nuk do të përfshijë më IPA-n.

Në vend të saj, financimi nga BE-ja për vendet e Ballkanit Perëndimor, do të mbështetet pothuajse tërësisht në një sistem të bazuar në kushte, të ngjashëm me Mekanizmin për Rimëkëm-

zën e zbatimit të reformave të ndryshme. Paralelisht, projektet infrastrukturore të propozuara nga vendet financohen përmes Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF).

Davor Pehchevski nga CEE Bankwatch Network tha se është pozitive që BE-ja po eksploron mënyra të reja për të avancuar qeverisjen përmes ligjit dhe mbrojtjen e mjedisit në Ballkanin Perëndimor, por është ende herët për të thënë nëse qasja e Instrumentit për Reformë dhe Rritje funksionon në këtë rajon. “Deri tani, provat nuk janë inkurajuese, pasi Agjendat e Reformës të vendeve përfshijnë shumë pak veprime për mjedisin. Është e arsyeshme të vazhdohet testimi i kësaj qasjeje, por jo që

Miratohe 17 projekte nga Komiteti i Monitorimit të Programit Interreg Greqi-Shqipëri

Në qytetin e Korçës u zhvillua takimi i tretë i Komitetit të Monitorimit, në kuadër të Programit “Interreg VI-A Greqi-Shqipëri 2021–2027”, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Komitetit, përfaqësuesve të autoritetit menaxhues, Sekretariatit të Përbashkët dhe Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës.

Gjatë fjalës së saj, drejtoresha e përgjithshme e Agjencisë, Eridana Çano, theksoi rëndësinë e angazhimit dhe përgjegjësinë e secilit anëtar në procesin e përzgjedhjes së projektpropozimeve, në përputhje me objektivat e programit dhe prioritetet zhvillimore të qeverisë shqiptare.

Thirrja e parë për propozime, me një buxhet total prej 17 milionë eurosh, shënoi një interes të jashtëzakonshëm, duke tejkaluar mbi dhjetëfish fondin e planifikuar, çka reflekton gatishmërinë dhe energjinë e partnerëve nga të dy anët e

kufirit për të bashkëpunuar në projekte të përbashkëta.

Takimi u përmbyll me miratimin e 17 projekt-

Ky proces përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit ndërkufitar, zhvillimit të qën-



propozimeve, të cilat u dakordësuan në unanimitet nga të gjithë anëtarët e Komitetit të Monitorimit.

drueshëm rajonal dhe rritjes së ndikimit pozitiv të fondeve të Bashkimit Evropian në nivel lokal dhe kombëtar.

Punësimi i të rinjve, Zyrat e Punës ndihmuan 40% të aplikantëve deri në 29 vjeç

Viti 2024 ka shënuar një rritje të ndjeshme të punësimit në radhët e të rinjve deri në moshën 29 vjeç, falë ndërhyrjes së Zyrave të Punës dhe programeve të specializuara të trajnimit dhe ndërmjetësimit.



Drejtoresha e Shërbimeve të Tregut të Punës, Gertiola Çepani, bëri të ditur se 40% e punësimeve të realizuara këtë vit kanë përfshirë të rinjtë, ndërsa programet për zhvillimin e aftësive digjitale,

si ai i kodimit, janë ndër më të kërkuarit dhe më të suksesshmit.

“Punësimi apo pjesëmarrja e tyre në kurset e formimit profesional, në programet e nxitjes së punësimit apo integrimit direkt në tregun e punës është

ka qenë ndër më të suksesshmit për të rritur aftësitë digjitale të të rinjve, mbi 90% janë të rinj”, deklaroi Çepani.


Procesi i aplikimit është gjithnjë e më i lehtësuar, duke u përshtatur me aftësitë teknologjike të brezit të ri. Të rinjtë mund të aplikojnë si fizikisht pranë Zyrave të Punës, ashtu edhe në mënyrë elektronike përmes portalit puna.gov.al ose shërbimeve të portalit e-Albania.

“Në portalin e punësimit, të gjithë të rinjtë, duke hapur llogarinë e tyre, mund të aplikojnë direkt për vendet e lira të punës pa ndërmjetësimin e Zyrave të Punës,” shtoi Çepani.

Nga ana tjetër, grup-mosha mbi 50 vjeç mbetet më e vështira për t’u punësuar, për shkak të interesit të ulët të kompanive për të punësuar apo rikualifikuar këtë kategori. Sektorët ku kjo grup-moshë është më e përfshirë janë tregtia, akomodimi ushqimor dhe industria përpunuese.



UNITED NATIONS
INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION



NGA FERMA NË TREGJET E HUAJA

Udhëzues për fermerët mbi përputhshmërinë me standardet GLOBALG.A.P



NGA FERMA NË TREGJET E HUAJA:

Udhëzues për fermerët mbi përputhshmërinë me standardet GLOBALG.A.P

Qëllimi i udhëzuesit GlobalG.A.P është të ndihmojë bizneset në procesin e tyre të certifikimit GlobalG.A.P, të sigurojnë përputhshmëri me praktikën ndërkombëtare bujqësore dhe të rrisin konkurrencën e tyre në treg.

GlobalG.A.P është një standard i njohur ndërkombëtar për praktikën e menaxhimit të fermave. Misioni i tij është të vendosë standarde dhe procedura të pranueshme gjerësisht për certifikimin e produkteve bujqësore në nivel global.



AVANTAZHE E CERTIFIKIMI GLOBALG.A.P



Për fermerët

- » Tregu të reja
- » Bëje e komercialisimit
- » Çmime më të larta



Për konsumatorët

- » Siguri e ushqimit: Mënyrë për të parandaluar kontaminimin e ushqimit
- » Zgjedhje të shumta dhe transparente
- » Përmirësimi i mirënjohjes së konsumatorit



Për ambientin

- » Integrimi praktikë të qëndrueshme bujqësore, duke përfshirë përdorimin e ujërave dhe përdorimin e tokës dhe biodiversitetit, duke mbrojtur rrethinë dhe kalibrit natyror
- » Praktika që reduktojnë ndikimin mjedisor të bujqësisë, siç janë menaxhimi i gjendës dhe përdorimi i kontrolluar i pesticidëve dhe përdorimi i tokës

HAPAT DREJT CERTIFIKIMIT

Për të marrë certifikimin GlobalG.A.P, duhet të ndiqni këta hapa:

1. Përgatitja dhe aplikimi (1-2 muaj)
 - » Planifikimi i formularit të aplikimit
 - » Dokumentimi i ushtrimit të certifikimit
 - » Resultati: Aplikimi juaj regjistruar në sistem

2. Kërkimi i dokumentacionit (1 muaj)
 - » Identifikimi i regjistrit të fermerit
 - » Verifikimi i praktikës së menaxhimit
 - » Resultati: Mënyrë për inspeksionin

3. Inspeksioni në fermë (1-2 muaj)
 - » Intervistat e fermerëve
 - » Inspeksionin e objektive dhe procesit
 - » Resultati: Identifikimi i përkrahjes së nevojshme

4. Raporti i Auditit & Verifikimi i Komitimit (1-2 muaj)
 - » Auditimi i ushtrimit të menaxhimit
 - » Ferra menaxhimit për përmirësimin
 - » Resultati: Udhëzime për korrigjimin e prishjeve

5. Zbatimi i Verifikimit Komitimit (1 muaj)
 - » Përmirësimi i praktikës së ushtrimit
 - » Dëgjimi i prishjeve të bëra
 - » Resultati: Ferra bën gati për verifikimin final

6. Verifikimi për Certifikimin (1 muaj)
 - » Organi certifikues shqyrton dokumentet
 - » Jepet vendimi final për certifikimin
 - » Resultati: Ferra bën gati për certifikimin

7. Marrja e Certifikimit GlobalG.A.P
 - » Ferra marrësi, organi certifikues dëshon certifikimin
 - » Ferra bën gati për certifikimin
 - » Përmirësimi: Çështje në tregje ndërkombëtare, çmime më të larta

KËRKESAT PËR CERTIFIKIM

- » Informacione për organizatën e fermerit, infrastrukturën, dhe higjienën (gati, udhëzimet për organizimin e rrugës brenda fermës për të kontrolluar aksesin dhe kontrollin e trafikut të mjeteve bujqësore).

- » Menaxhimi i tokës (p.sh. praktika për tokën e regjistrit të gjatë ose të shkurtër dhe përdorimi i regjistrit të përdorimit të tokës për të mbajtur fertilitetin e tokës).

- » Mbrojtja e kulturave bujqësore: IPM, përdorimi i pesticidëve dhe mbajtja e regjistrimit (p.sh. përdorimi i feromonëve).

- » Përdorimi i ujërave, standardet e cilësisë dhe praktikën e përdorimit.

- » Përdorimi i plehrave: aplikimi i duarve, rullit, dhe mbajtja e regjistrimit për plehrat (p.sh. plehrat në depo të mbyllura dhe mbajtja e regjistrimit të kësaj dhe gjatë të plehrave të përdorimit).

- » Kallimi dhe trajtimi i produkteve: procedurat për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e produkteve nga kalimi deri të naftës.

- » Shërbimi, siguria dhe mirënjohja e punëtorëve: udhëzime për sigurinë e punëtorëve, trajnimin, dhe kushtet e punës (p.sh. organizimi i trajnimeve për procedurat e sigurisë në përdorimin e mjeteve bujqësore).

PËRFITIMET E INTEGRATED PEST MANAGEMENT (IPM)

Përfitimet Mjedisore

- » Shmang përdorimit të tokës të pesticidëve kimike që mund të ndikojnë në tokën dhe të degradojnë tokën.
- » Bujqësi e integruar të dhënitë, si llojet dhe shumësitë, gënjatë, ndikimin në shpërbërjen natyrore.
- » Përdorimi i metodave të ndryshme ndihmon në shpërbërjen e tokës dhe shpërbërjen e tokës.

Përfitimet Ekonomike për fermerët

- » Më të lartë dhe më të shpejtë bujqësi
- » Më të lartë dhe më të shpejtë bujqësi – Produktet me më pak mbetje kimike janë më të kërkuara në tregjet organike dhe ndërkombëtare.
- » Reduktimi i shpenjimeve në mbajtjen e kontrollit të integruar dhe shpërbërjen e tokës në mbajtjen e regjistrimit dhe përmirësimin të ardhurave të fermerëve.

Përfitimet për Shërbimet e Punëtorëve dhe Konsumatorëve

- » Më të shpejtë ndaj pesticidëve kimike
- » Më të shpejtë ushqim – Produktet bujqësore të prodhuara me IPM janë më të sigurt për konsumin, se me pak mbetje pesticidë.
- » Më të shpejtë e konsumatorëve ruralë – Reduktimi i shpenjimeve me pesticide bujqësore ndihmon në çmimin e produkteve për konsumin dhe fermerët.

Përfitimet Teknologjike dhe Praktikë

- » IPM integron teknologjinë, feromonet, metodat mekanike dhe biologjike për menaxhimin e dëmtuesve.
- » Më të shpejtë përdorimi të veprimit të pestitëve kimike, IPM përdor një kombinim teknikësh për rezultate më të mira afatgjatë.
- » Fermerët që zbatojnë IPM mund të marrin certifikime organike dhe GlobalG.A.P, duke bërë akses në tregje të reja.

DOKUMENTIMI DHE MBAJTJA E TË DHËNAVE

Dokumentacioni i nevojshëm përshin hartën e fermës, regjistrat e kulturave, regjistrat e përdorimit të pesticidëve dhe regjistrat e trajnimeve të punëtorëve.

Praktikat e mbajtjes së regjistrimeve: përdorimi i sistemeve të automatizuara për regjistrimin e të dhënave, dhe regjistrimi i dosjeve të regjistrimit në mënyrë që të përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësues.


Roli i trupës së certifikimit

- » Konsultim fillostar për të shoqëruar procesin dhe kërkesat e certifikimit
- » Shërbime vlerësimi paraprak dhe planifikimi për auditimin e radhës
- » Komente dhe rekomandime për veprime korrigjuese
- » Lëshon certifikatën GlobalG.A.P nëse ferma plotëson kërkesat e përputhshmërisë
- » Auditimi të rregullta mbledhëse për të siguruar përputhshmërinë e vazhdueshme me standardet GlobalG.A.P
- » Monitoron veprimet korrigjuese dhe përmirësimet e bëra bazuar në gjetjet e auditimeve të mëparshme
- » Menaxhon procesin e rinovimit për të ruajtur vlefshmërinë e certifikimit
- » Ofron mbështetje dhe udhëzime të vazhdueshme për të ndihmuar fermerin të ruajë përputhshmërinë
- » Ofron përditësimet mbi ndryshimet në standardet dhe kërkesat e GlobalG.A.P



NJË INICIATIVË GLOBALE

GOSP ndihmon prodhuesit e vegjël për të përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre, të përmbushin standardet ndërkombëtare dhe të eksportojnë nëpër botë



Sekretariati i Shërbimit për Çështjet Ekonomike SECO

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni:
E-mail: e.zhezha@unido.org, m.prebibaj@unido.org

KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



INOVACION

Inteligjenca artificiale në agrobiznes, sfida dhe mundësi për një transformim të qëndrueshëm

Dr. Aulona Veizi
Presidente e Grupit Vendor të Veprimave (GVV) VJONA

Ky artikull përmban një sintezë të rezultateve dhe përfundimeve të Konferencës së organizuar nga CIHEAM Zaragoza, e fokusuar në potencialin transformues të inteligjencës artificiale (IA) në sektorin agro-ushqimor.

Hyrje


Hyrje Inteligjenca artificiale (IA) dhe dixhitalizimi po revolucionarizojnë sektorin agro-ushqimor. Nga parashikimi i rendimentit të përmirësuar deri te menaxhimi i saktë i burimeve dhe këshillat agronomike të personalizuar, IA po shndërrohet në një mjet thelbësor për transformimin e bujqësisë drejt qëndrueshmërisë. Përmes përvojës sime në konferencën e CIHEAM Zaragoza, ky artikull paraqet një përshkrim të sfidave, mundësive dhe strategjive të adoptimit të IA në sektorin agro-industri.

1. IA: Një mjet dhe jo qëllim në vetvete

IA nuk është qëllim në vetvete, por një mjet i fuqishëm për të përballuar sfidat e ndërlikuara me të cilat përballen sistemet ushqimore: ndryshimet klimatike, humbja e biodiversitetit, pabarazitë sociale dhe ekonomike dhe varësia nga zinxhirët e gjatë të furnizimit. Transformimi digjital duhet të vendosë fermerin dhe prodhuesin në qendër, ndërsa teknologjia duhet të jetë e përshtatshme me nevojat konkrete të sektorit.


IA ndihmon në optimizimin e vendimmarrjes: nga parashikimi i rendimentit të të vjelave, identifikimi i hershëm i sëmundjeve dhe dëmtuesve, te menaxhimi i saktë i ujit dhe përdorimi racional i plehrave. Aplikimi i asistentëve virtualë për këshillim agronomik po jep rezultate të menjëhershme, ndërsa modelet digjitale dhe sensorët në terren po bëhen pjesë e pandashme e bujqësisë moderne.

Ndikimi i inteligjencës artificiale në sektorin bujqësor



Siç shohim dhe nga grafiku nëpërmjet IA kemi % të lartë të reduktimit të fertilizanteve, % të lartë të reduktimit të përdorimit të ujit dhe rritje e produktivitetit. Studim dhe të dhëna të mara për Spanjën dhe Evropën.

Investime në inteligjencën artificiale bujqësore



E ardhmja e ushqimit dhe bujqësisë" (FAO, 2024); "Inovacioni bujqësor për sisteme ushqimore të qëndrueshme" (Banka Botërore, 2023).


Ne nuk po përballemi me një problem ekskluzivisht teknologjik

(Shih grafikun e tretë)

Sfidat për adoptimin e gjerë të këtyre teknologjive mbeten: mungesa e besimit, kostot e larta, mungesa e lidhjes së qëndrueshme në internet dhe mungesa e aftësive digjitale. Prandaj, është thelbësore që digjitalizimi të jetë gjithëpërfshirës, duke ndihmuar jo vetëm fermerët e mëdhenj por edhe ata të vegjël.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është bashkëpunimi mes institucioneve publike dhe private, universiteteve, organizatave dhe bizneseve agroteknologjike. Në këtë drejtim, duhen marrë iniciativa si krijimi i katedrave të inteligjencës artificiale në bujqësi, zhvillimi i binjakëve digjitalë për fermerat, analizimi i të dhënave satelitore dhe trajnimi i teknikëve dhe agronomëve për të përcuruar dijen në terren.

Barrierat kryesore për adaptimin ndaj IA



"Pengesat ndaj dixhitalizimit në bujqësi: Një analizë globale" (WEF, 2023); "Transformimi dixhital në bujqësinë e Amerikës Latine" (IDB, 2024).

IA nuk zëvendëson përvojën njerëzore, por e fuqizon atë. Përdorimi i IA nuk ka për qëllim të heqë profesionistët nga vendimmarrja, por t'i pajisë ata me mjete që u japin më shumë saktësi, efikasitet dhe fleksibilitet në menaxhim.

Në përfundim, IA në sektorin agro-ushqimor është tashmë një realitet, por ka ende shumë për të bërë për ta shfrytëzuar atë në maksimum.

Thirrje të gjithë aktorëve që të ecin së bashku në këtë rrugë të transformimit digjital të sektorit agro-ushqimor. Duhet një qasje e orientuar drejt bashkëpunimit, trajnimeve të përbashkëta, rritjes së aksesit për të gjithë dhe krijimit të besimit në përdorimin etik dhe të përgjegjshëm të inteligjencës artificiale.

Denaj: Garancia Sovrane dhe Paketa e Maleve nxisin investimet në agroturizëm

Në Reç, Malësi e Madhe, familja Maleci prej rreth 7 vitesh ka krijuar një histori suksesi me investimin në agroturizëm, si një sipërmarrje që ka kthyer traditën, natyrën dhe mikpritjen në një destinacion të preferuar për turistët vendas dhe të huaj.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj ndau në rrjete sociale pamje nga ky investim, teksa e cilësoi këtë sipërmarrje shembull të një modeli të qëndrueshëm ekonomik që nxit punësimin lokal, forcon zinxhirin agroushqimor, dhe kontribuon në zhvillimin rural.

Me një ndërlidhje të shkëlqyer me fermerët e zonës, agroturizmi në Reç

ofron produkte të freskëta dhe cilësore "Made in Albania", si mish, djathë, perime, mjaltë dhe sidomos gështenjat karakteristike të Reçit.

Denaj shprehu mbështetjen për zgjerimin e agroturizmeve.



"Me linjën e financimit të Kredisë së Butë, të mbështetur nga Garancia Sovrane dhe Paketa e Maleve, nxisim investimet në agroturizëm për zgjerimin, modernizimin dhe zhvillimin e ekonomisë lokale", tha Denaj.

Drejtori i Tatimeve, Binaj: Sistem digjital me bankat për mbledhjen e borxheve

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, Ilir Binaj, bën të ditur se një sistem elektronik do të ndërtohet së bashku me bankat për bllokimin e llogarive bankare, si një masë e mëtejshme për subjektet që nuk shlyejnë detyrimet në kohë, edhe pas lajmërimeve të kryera.

Në një intervistë televizive, ai theksoi se, "një masë që po implementojmë është ngritja e një sistemi digjital, i cili do të lehtësonte dhe përshpejtonte bllokimet dhe zhblokimet e llogarive për subjektet të cilat nuk paguajnë në kohë".

Sipas tij, përpjekja për të mbledhur borxhin është e vazhdueshme dhe rritja ka

qenë e menaxhueshme nga administrata tatimore.

Binaj tha se, "vlëra më e madhe lidhet me tatim-

fitimin dhe sigurimet shoqërore, ndërsa zërin kryesor e zënë bizneset e tregtisë, pastaj të prodhimit".



AGROTURIZËM

IPA III - Mbështetje projekteve ndërkufitare në turizëm, mjedis dhe kulturë

Komiteti i Përbashkët i Monitorimit të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA III mes Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, zhvilloi një takim pune online.

Në takim morën pjesë përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar Shqiptar, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale e Maqedonisë së Veriut, Delegacionet e BE-së, si dhe institucione shqiptare dhe maqedonase.

Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës bën të ditur se “takimi shërbeu si një hap i rëndësishëm në qeverisjen e programit, ku anëtarët e Komitetit shqyrtuan dhe dhanë opinionet këshilluese mbi listën operacionale të propozuar për financim nga BE-ja, në kuadër të thirrjes së fundit”.

Sipas SASPAC, diskutimet u fokusuan në projektet

ndërkufitare me ndikim, të përputhura me qëllimet kryesore të programit, duke përfshirë:



Projektet që synojnë zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, promovimin e ekonomive lokale, eko-turizmin, si dhe përmirësimin e infrastrukturës kulturore dhe natyrore në zo-

nën ndërkufitare.

Gjithashtu, u diskutua për projektet që forcojnë kapac-

itetet e mbrojtjes së mjedisit, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike për reagim emergjent dhe menaxhimin e qëndrueshëm të riskut në zonat e largëta ndërkufitare.

Rabdishti, si model i turizmit rural

Fshati Rabdishtit në Dibër, është kthyer në një destinacion të preferuar për vizitorët vendas dhe të huaj, jo vetëm për bukuritë natyrore, por edhe për agroturizmet e reja që po shtojnë ofertën turistike të zonës.

Rabdishti është një nga

rit rural dhe turizmit, ku diskutuan mbi agroturizmin dhe zgjerimin e ofertës turistike në këtë zonë.

Në kuadër të eventit “Tregime Fshati”, u promovuan paketat turistike që fshati ofron, si: turi i shtëpive pritëse,

oborrit e një shtëpie tradicionale pritëse, si një kujtim i veçantë për gjithë komunitetin.

Pesë familje hapën për herë të parë dyert e shtëpive të tyre për të ofruar një përvojë autentike fshati.

Sot, Rabdishti ka gati 20 dhoma për këdo që dëshiron të kalojë një fundjavë ndryshe në fshat.

Fshati Rabdisht është një nga 100 fshatrat turistikë në Shqipëri. I ndodhur në një peizazh malor, i ndërtuar më shtëpi tradicionale me gurë, çatitë prej rrase guri, si dhe rrugët me kalldrëm i japin pamje të veçantë dhe unike duke u njohur “fshati i gurtë”.

Rabdishti shtrihet në majën e Luginës së Shërimit e cila ka marrë emrin e saj nga vetitë kuruese të burimeve termale të Peshkopisë dhe nga pjesa malore të kullotës së bjeshkës së Rabdishtit dhe malit me të njëjtin emër të vargmalit Deshat-Korab.

Vizitorët e shumtë që frekuentojnë këtë fshat pëlqejnë jetën tipike të fshatit, bujtinat tradicionale në Rabdisht, ku mikpritja dhe gatimet tradicionale shijohen si askund në rajonin e Dibrës.



fshatrat ku institucionet e linjës në bashkëpunim me donatorët, po punojnë për ndërtimin e një modeli turizmi rural të bazuar te komuniteti.

Fundjavën e kaluar, familjet në fshatin Rabdisht mirëpritën grupin e vizitorëve nga Tirana, njëherazi specialistë të sekto-

përvoja në fermë, tre shtigje të reja, dhe ballkoni panoramik, ndër të tjera. Ndërsa tryeza e dialogut mes aktorëve lokalë diskutoi edhe hapat e ardhshëm në zhvillimin e turizmit në zonë.

Mbrëmja u përmbyll me kinemanë verore, vendosur në

Abuzimi me çmimin e qershive - Prodhim i pakët prej kushteve atmosferike, por tregtarët e trefishuan çmimin

Fermerët thonë se ky vit ka qenë më i dobët sa i përket prodhimit të qershisë, por përveç kësaj janë të shqetësuar me abuzimin e çmimit nga tregtarët që e trefishuan atë që në ditët e para.

Tregu i vështirë dhe mungesa e fuqisë punëtore nuk i ka dekurajuar fermerët në Frakull të Fierit.

Babë e bir prej 25 vitesh kultivojnë bostanin dhe thonë se janë shumë të lidhur me tokën e tyre.



Java e Kulturës Italiane në disa qytete të vendit

Kryeqyteti po bëhet gati të mikpresë Javën Kulturore Italiane e cila nis në datën 1 dhe mbyllet më 8 qershor.

Organizatorët premtojnë një javë plot muzikë, art, shije dhe kulturë italiane. Në të gjitha aktivitetet do të jetë hyrja e lirë për artdashësit të cilëve do u ofrohet muzikë klasike, koncerte, shfaqje teatrore, filma dhe aktivitete të tjera në sheshe.

Nga 1 deri në 8 qershor do të jetë një javë që bashkon Italianë dhe Shqipërinë me tradita të mrekullueshme.

Java e Kulturës Italiane do të nisë me një koncert në Kishën Katolike tek Rruga e Kavajës, nga Orkestra Rinore e Magna Grecia, që vjen nga rajoni i Puglia-s.

Diçka e veçantë do të jetë aktiviteti Fashion Chat me stilistë të rinj, që do të zhvillohet datën 2 qershor në COIN, ndërkohë që koncerti i muzikës klasike zhvendoset në hapësirën e Amfiteatrit të Durrësit. Gjithashtu dhe Vlora do të gjallërohet nga koncerti i grupit italian “Neri per caso”, të cilët do të festojnë 30-vjetorin e fitores së tyre në Sanremo.

Tek Piramida në Tiranë do të nisë një cikël diskutimesh

mbi arkitekturën, ndërkohë që mbrëmjen e 4 qershorit banorët dhe turistët e Beratit mund të shijojnë një koncert jazz-i nga

Italiane do të jetë Gjirokastra, ku do të vihet në skenën teatrore një produksion i përbashkët, titulluar “Onora tuo padre”,



“Aperitivo Italiano”.

Një tjetër qytet i përfshirë në kalendarin e Javës Kulturore

gjithashtu do të ketë edhe një projeksion filmi mbi këngëtares Mia Martini.

Rritet numri i turistëve në katund të vjetër, fshati në Mirditë po tërheq shumë vizitorë të huaj

Pranvera me mot të ngrohtë dhe me diell ka rritur numrin e turistëve në Katundin e Vjetër,

vendas, por edhe të huaj të pasionuar pas natyrës, traditës dhe historisë që mbart ky fshat



pas natyrës, traditës dhe historisë që mbart ky fshat i lashtë



vit shtua edhe një muaj më shumë sepse çdo vit ka vazhduar maj

një fshat piktoresk i vendosur vetëm 6 kilometra larg Rrugës së Kombit, në bashkinë Mirditë.

Zona po tërheq gjithnjë e më shumë vizitorë, jo vetëm

i lashtë.

“Këtë vend e kemi gjetur në internet dhe po na pëlqen shumë. Natyrë është e mrekullueshme. Ke mundësi të ecësh në natyrë. Unë dua të

vlerësoj dhe mikpritjen këtu. Njerëzit janë shumë miqësor dhe të dashur. Këto ditë që po kaloj këtu janë fantastike dhe është e sigurtë që do të rikthehem sërish”, u shpreh një turiste.

“Ja vlen që të kalosh disa ditë këtu në Katund të Vjetër, pasi qenka një vend i mrekullueshëm. Krahas bukurive edhe ushqimi është shumë i shijshëm. Unë kam shëtitur në shumë vende të botes, por zona si kjo nuk ka arritur të shoh dhe ta shijoj kaq shumë”, tha një turiste tjetër.

Sipas operatorëve turistikë lokalë dhe banorëve të zonës, prenotimet për këtë sezon janë mjaft të kënaqshme. Megjithatë, ata theksojnë nevojën për më shumë investime, veçanërisht në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe të rrjetit elektrik, në mënyrë që potenciali turistik i zonës të shfrytëzohet plotësisht.

“Prenotimet janë të shumta sidomos nga turist të vendeve të ulëta. Këtë vit është shtuar dhe një muaj më shumë sepse çdo vit ka vazhduar në maj ndërsa këtë vit ka filluar në prill”, u shpreh Bajron Nikolli, operator turistik.

Sipas të dhënave zyrtare, në bashkinë Mirditë regjistrohen deri në 70 mijë vizitorë në vit, ku pjesa më e madhe e tyre zgjedhin të vizitojnë Katundin e Vjetër.

Smart Bolus, risi në menaxhimin e shëndetit të kafshëve blegtorale

Sektori rural po synon zgjerimin e përdorimit të teknologjive inovative në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, për rritjen e prodhimit sipas standardeve më të mira dhe lehtësimin e kushteve të punës për fermerët.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, tha se, prezantimi nga GIZ i një prej teknologjive më të avancuara për menaxhimin e shëndetit të lopëve në Shqipëri, është një modeli inovativ që rrit efikasitetin e menaxhimit të tufave blegtorale.

Sipas saj, përmes inovacionit të monitorimit digjital, SmaXtec ka sjellë Smart Bolus-in, teknologji që tashmë përdoret në mbarë botën.

Përdorimi i kësaj teknologjie mundëson monitorim të vazhdueshëm të temperaturës dhe aktivitetit të lopës gjatë gjithë ditës, gjurmim të shëndetit në kohë reale, zbulim të hershëm

të sëmundjeve.

Denaj e vlerësoi zbatimin e teknologjisë inova-

Smart Bolus-it shënon një risi në menaxhimin e shëndetit të lopëve të qumështit në fermë”,



tive me ndikim në rritjen e mirëqenies së kafshëve, falë reduktimit të përdorimit të antibiotikëve si dhe produktivitete më të lartë të qumështit nëpërmjet menaxhimit proaktiv të shëndetit.

“Implementimi me sukses i

tha Denaj.

Ministria e cilësoi një hap të rëndësishëm drejt një blegtorie të qëndrueshme, të bazuar në përgjegjshmëri dhe të dhëna, me respekt për standardet më të larta të shëndetit, mirëqenies dhe kujdesit për kafshët.

Skema e mbështetjes në Bujqësi, AZHBR: vlerësimi sipas afateve të parashikuara

Aplikimet në Skemën Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi për vitin 2025 u mbyllën më 30 maj, duke regjistruar 69 mijë aplikime, të përbëra nga rreth 71 mijë fermerë nga të gjitha qarqet e vendit, të cilët aplikuan për të përfituar financim nga fondet e vëna në dispozicion nga qeveria shqiptare.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njoftoi përmes rrjetit sociale Facebook se “procesi i vlerësimit administrativ vijon në përputhje me kriteret dhe rregullat e përcaktuara në skemë, sipas afateve të parashikuara”.

Pas aplikimit me vetëdeklarim në e-Albania, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural nis procesin e verifikimit dhe plotësimin e dosjeve për secilin aplikant. Një pjesë e mirë e dokumentacionit gjenerohet direkt nga e-albania, ndërsa pjesa tjetër duhet të dorëzohet nga fermerët. Ndër kriteret kryesore është toka në pronësi apo përdorim të fermerëve përmes një kontrate qiraje të noterizuar si dhe mospasja e detyrimeve në Institutin e Siguri-

meve Shoqërore.

Nga ana tjetër, për mbjell-

Këtë vit, fermerët do të përfitojnë pagesa cash për naf-



jet e bëra paraprakisht apo për numrin e krerëve në blegtori dhe numrin e koshereve në bletari, do të kryhet verifikimi në terren. Pas përfundimit të të gjithë procedurës, do të nisë disbursimi i fondeve për fermerët.

tën që përdorin për punime të mekanizuara në bujqësi.

Fondi është 3.2 miliardë lekë dhe do t'i jepet më shumë prioritet financimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, të cilat do mund të përfitojnë në masën 100%.

Rama: “Water Bike” në Kukës, lëvizja mbi ujë drejt qetësisë, natyrës dhe aventurës

Në Liqenin e Kallabakut në Novesë të Kukësit ofrohet një eksperiencë ndryshe për vizitorët dhe dashamirësit e natyrës së paprekur.

Biçikletat e ujit (Water Bike) janë tashmë një mënyrë unike për të shijuar panoramën dhe emocionet e aventurës mbi ujë.

Kryeministri Edi Rama ndau një video në rrjetet so-



cialë nga pedalimi i disa turistëve mbi sipërfaqen e qetë të liqenit.

“Water Bike në Kukës! Një trend i ri po lëviz mbi ujë, drejt qetësisë, natyrës, dhe aventurës”, shkruan Rama.

Liqeni i Kallabakut është një ujëmbledhës me sipërfaqe rreth 7 ha, i pozicionuar mes pyjeve të përbërë nga ahu, brendhi, mështekna etj.

Programi kombëtar i praktikave të punës, deri në 250 profesionistë të rinj do të punësohen në administratën publike

Këshilli i Ministrave miratoi programin kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institu-


vjeç, të diplomuar në ciklin e parë ose të dytë të arsimit të lartë, që nuk kanë qenë pjesë e mëparshme e programit dhe

Gjatë praktikës, të rinjtë përfitojnë kompensim financiar prej 500 lekë në ditë dhe trajnim në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).

Institucionet pjesëmarrëse janë të detyruara të caktojnë personat kontakti dhe mbikëqyrës për praktikantët, ndërsa deri në 250 praktikantë përzgjidhen për punësim kontraktual në administratën shtetërore dhe institucionet publike.

Menaxhimi dhe koordinimi i programit realizohet nga ministria përgjegjëse për rininë, ndërsa Agjencia Kombëtare e Rinisë siguron fondet për kompensimin financiar dhe pagesat për trajnim.

Ky program ka për qëllim integrimin e profesionistëve të rinj në shërbimin civil dhe forcimin e kapaciteteve të administratës publike shqiptare.



cionet publike për profesionistë të rinj, me qëllim përfitimin e përvojës profesionale dhe zhvillimin e aftësive në sistemin administrativ.

Programi synon të përfshijë të rinj nga moshë 21 deri në 29

që nuk kanë punuar më parë në administratë publike.

Programi përbëhet nga një periudhë praktike 3-mujore dhe një periudhë punësimi 1-vjeçar me kontratë, që njihen si përvojë pune gjatë rekrutimit.

Praktikat më të avancuara evropiane, AZHBR në konferencën e Agjencive të Pagesave në Holandë

Drejtoresha e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), Ardita Kuçi, mori pjesë në konferencën Panta

net teknologjike dhe sfidat e përbashkëta në menaxhimin e politikave bujqësore.

Gjatë konferencës, drej-

Në fokus të veçantë ishte prezantimi i platformës kombëtare e-Albania dhe asistentit dixhital, si shembuj të suksesshëm që e pozicionojnë Shqipërinë si një shembull inovator në përdorimin e inteligjencës artificiale për modernizimin e shërbimeve publike, në funksion të përsheptimit të integritetit evropian.

Konferenca trajtoi tema kyçe si siguria e informacionit, përdorimi i dronëve në kontrollin e subvencioneve për sektorin e bujqësisë dhe inovacionet në sistemet e administrimit të parcelave tokësore.

Pjesëmarrja e AZHBR-së në këtë konferencë thekson angazhimin për të integruar praktikën më të avancuara evropiane, duke nxitur digjitalizimin dhe përmirësuar efektivitetin e mbështetjes ndaj sektorit bujqësor në Shqipëri.



Rhei, në Leiden, Holandë.

Kjo konferencë përfaqëson një forum kyç për agjencitë paguese të Bashkimit Evropian, ku ekspertë dhe drejtues nga vendet anëtare ndajnë praktikën më të mira, inovacio-

toresha e AZHBR mbajti një prezantim ku ndau përvojat e Shqipërisë në përdorimin e inteligjencës artificiale në shërbimet dixhitale, si dhe teknologjitë për menaxhimin e skemave bujqësore.

